



AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK

TREGUESIT STATISTIKORE DHE FINANCIARE TE
TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Viti 2012

TELEFONI CELULARE

TELEFONI FIKSE

INTERNET

Prill 2013

I.HYRJE	3
II. PANORAME E PERGJITHSHME	4
III. TELEFONIA CELULARE	10
III.1 Struktura e perdoruesve dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare	10
Sherbime te reja: 3G	16
IV. TELEFONIA FIKSE	17
IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut.....	17
V. INTERNETI	
V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre.....	19

I.HYRJE

AKEP, me qellim informimin e publikut, paleve te interesuara dhe te sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike me treguesit kryesore te ketij tregu, ne vijimesi te raporteve periodike te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al ne seksionin Statistika, ka pergatitur kete raport ne te cilin publikohen treguesit kryesore te tregut per vitin 2012 dhe ndryshimet me periudhat e meparshme.

Ky raport eshte pergatitur duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare, Albtelecom si dhe te dhenave te Operatoreve Alternative dhe Ofruesve te sherbimeve, sipas formuleve te Rregullores te te dhenave statistikore, te plotesuar nga sipermarresit e autorizuar nga AKEP. Per shkak te ruajtjes se konfidencialitetit te te dhenave, jo te gjithe treguesit e raportuar nga operatoret publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyre periodike dhe mund te pasurohet edhe me tregues te tjere apo informacion me te plote per operatoret alternative.

II. PANORAME E PERGJITHSHME

Numri i sipërmarrësve të regjistruar për ofrim rrjetesh apo shërbimesh publike të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2012 pas aplikimit në bazë të rregullores së re në “Regjistrin e Sipërmarrësve” numri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, është 157 në krahasim me 204 sipërmarrës të regjistruar deri në fund të vitit 2011. Ky aplikim on-line mundësoi konfirmimin nga sipërmarrësit të shërbimeve të autorizuara dhe konkretisht:

- shërbimin publik telefonik të lëvizshëm 4 sipërmarrës;
- shërbimin publik telefonik fikse 73 sipërmarrës;
- shërbimin publik transmetim të dhënash 53 sipërmarrës;
- shërbime me vlerë të shtuar 33 sipërmarrës;


Ecuria e tregut të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2012 ka tregues pozitiv dhe në mënyrë specifike për secilin nga tre segmentet e tij: telefoninë e lëvizshme, fikse dhe të Internetit paraqitet si në vijim:

Në fund të vitit 2012, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme (karta SIM aktive) arriti në rreth 5.6 milion duke u rritur me rreth 7% krahasuar me vitin 2011. Ndërsa numri i pajtimtarëve aktive (pajtimtare që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) arriti në 3.5 milion, që përben rritje me 14% në krahasim me vitin 2011. Numri i përdoruesve për 100 banorë në fund të 2012 ishte 198%, për kartë SIM aktive dhe 125% e matur me përdorues aktive.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2012 arriti në rreth 311 mijë, nivel i cili përbën një rënie me rreth 27000 pajtimtare apo 8% në krahasim me vitin 2011. Rënia ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Albtelecom me rreth 29 mijë. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri arriti në 11%, nivel që është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej rreth 35%) dhe vendet e rajonit.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë ndër vite të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe celulare, ku vihet re rritja shumë e madhe e telefonisë celulare dhe rritja shumë e vogël e telefonisë fikse.

Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2012



Sipas të dhënave per vitin 2012, nga Albtelecom dhe operatorët alternative, Vodafone dhe AMC per numrin e pajtimtareve me akses ne broadband 3G (me karta USB/modem) si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton qe numri total i pajtimtarve me akses broadband ne Internet eshte rreth 215 mije qe perben nje rritje me rreth 24% ne krahasim me vitin 2011. Numri i pajtimtareve me akses broadband per 100 banore eshte 7.6%. Numri i pajtimtareve familjare me akses broadband eshte rreth 200 mije apo afërsisht 27% e familjeve.

Grafiku i meposhtem jep ne menyre krahasimore normat e penetrimit ne Shqiperi te sherbimeve te telefonise fikse, celulare dhe aksesit broadband me vendet e BE.

Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2012





Figura 3. Krahasimi i normave te penetrimit: Shqiperi vs mesatare e BE27



Tregues Financiare te sektorit

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2012 ishin rreth 55377 milion lek të cilat përbejnë një rritje prej rreth 6.65 % në krahasim me vitin 2011 kur të ardhurat ishin 51922 milion LEK. Rritja e të ardhurave të sektorit ka ardhur kryesisht nga rritja e të ardhurave të operatorëve celularë.

Peshen kryesore te ketyre te ardhurave e zene ato qe vijne nga rrjetet celulare, te cilat per 2012 jane 42.01 miliard leke, kundrejt 39.2 miliard leke qe ishin ne vitin 2011, pra sic vihet re ne sektorin celular ka nje rritje te te ardhurave per vitin 2012 rreth 7.2 %, krahasuar me vitin 2011.

Edhe ne te ardhurat qe vijne nga rrjete fikse (Albtelecom + OA) per vitin 2012, vihet re nje rritje, krahasuar me nje vit me pare 2011, nga 12.8 miliard leke ne rreth 13.4 miliard lek, apo e thene ndryshe ka nje rritje prej rreth 4.7%. Brenda vete sektorit te telefonise fikse vihet re nje rritje prej rreth 12 % ne te ardhurat e Albtelecom, krahasuar me 2011, por ka nje renie ne te ardhurat e 2012 per OA, renia e cila eshte afersisht prej rreth 15 % krahasuar me te ardhurat e vitit 2011.

Sipermarresit alternative nder me kryesoret sipas te ardhurave mund te vleresohen operatorët ABcom, ASC, Primo, Abissnet, Nisatel, IT-Tirana, ATU, etj, të cilët së bashku zene rreth 5 % të të ardhurave të sektorit, apo mbi 80% të peshes totale te te ardhurave te operatorëve alternative.

Figura 4. Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2012)




Figura 5: Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2012)





Figura 6: Pjeset e tregut ne te ardhura te operatorëve alternative ne tregun e komunikimeve elektronike per vitin 2012



Investimet

Per sa i perket investimeve te kryera ne vitin 2012, tabela e meposhteme paraqet te dhenat sipas deklarimeve te operatoreve. Ka nje renie te investimit ne krahasim me 2011, dhe me specifike per rrjete fikse dhe celulare paraqiten ne tabelen e meposhtme.

Tabela 1: Investimet e operatoreve te komunikimeve elektronike ne total (2010-2012)

	2010	2011	2012
Investime ne rrjete fikse (infrastruktura)	1,820	3,254	2,511
Rrjet telefonik PSTN/ ISDN	524	427	690
Rrjet IP (ISP) Platforma IP	222	1,434	1,822
Infrastruktura rrjet backbone Fiber Optike	1,074	1,393	669
Investime ne infrastruktura rrjeti celulare	8,089	6,831	5,576
Total	9,909	10,085	8,087

III. TELEFONIA CELULARE

III.1 Struktura e perdoruesve dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare


Numri i perdoruesve celularë prej 5.6 milione ne fund te 2012, i referohet numrit te kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para aftit 1 vjecar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë numri perdoruesve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (përdorues aktivë), në fund të vitit 2012 arriti 3.5 milione krahasuar me 3.1 milione në fund të 2011. AKEP gjykon se ndryshimi në vlerat e cituara më sipër ndodh për shkak se në shifrën numrit të kartave SIM te permendura më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri (emigrantet/turistet ne periudhen e veres nuk përfshihen ne perdorues aktive), si edhe një numër pajtimtarësh që mund të mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive. Praktikën e raportimit ndryshojne ne vende te ndryshme, pasi ka vende qe raportojne numrin e perdoruesve celulare sipas kartave SIM aktive¹, si edhe vende qe raportojne sipas perdoruesve aktive. Në referenca të tjera në këtë raport, AKEP i referohet kryesisht numrit të kartave SIM aktive si numri i pajtimtarëve celularë, por nderkohe ne disa raste jepen edhe tregues bazuar ne numrin e perdoruesve aktive.

Figura e meposhtme paraqet ecurine e numrit te perdoruesve celulare sipas kartave SIM dhe perdorues aktive. Te dhenat per perdorues aktive jane te disponueshme duke filluar nga viti 2010, pasi me pare raportojne vetem numri i perdoruesve sipas kartave SIM aktive. Numri i perdoruesve për 100 banorë ne fund te 2012 ishte 198%, per karta SIM aktive dhe 125% e matur me perdorues aktive. Penetrimi sipas perdoruesve aktive ishte i perafret me penetrimin mesatar te vendeve te BE-se.

Numri i perdoruesve sipas kartave SIM u rrit me 7% ne 2012 krahasuar me 2011, ku rritjen me te madhe e ka pasur Eagle Mobile me 28% ndersa Plus ka pasur rritjen me te madhe me 24%, ndersa numri i perdoruesve aktive ne 2012 u rrit me 14%, ku rritjen me te madhe e kishte AMC me 22%, dhe rritjen me te vogel Eagle Mobile me 5%.

¹ Ne menyre te ngjashme, Mali i Zi raporton norme penetrimi te telefonise celulare afersisht 200%, e cila i dedikohet numrit te larte te vizitorve/turisteve ne raprt me popullsine rezidente te ketij vendi.

Figura 8. Ecuria e numrit të pajtimarëve celularë 2010-2012



Burimi: Të dhënat periodike të operatorëve.

Struktura e përdoruesve

Tabela e mëposhtme paraqet strukturën e përdoruesve të katër operatorëve celularë për përqindjen e përdoruesve aktive në raport me numrin e kartave SIM aktive dhe përqindjen e përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve.

Tabela 3. Struktura e përdoruesve celularë 2012

	AMC	Vodafone	Eagle Mobile	Plus	Total
Raporti Përdorues Aktiv/SIM	75%	74%	31%	67%	63%
Raporti përdorues me Kontratë/SIM Total	9%	5%	14%	28%	10%
Raporti përdorues me Kontratë/ Total Aktiv	12%	7%	46%	42%	16%

Përdoruesit aktive përbejnë 63% të numrit total të kartave SIM aktive. Përqindjen më të madhe të këtij treguesi e kanë AMC dhe Vodafone me 75% dhe 74% respektivisht, ndërsa më të ultën e ka Eagle Mobile me vetëm 31%.

Përdoruesit me kontratë zënë 10% të numrit total të përdoruesve të matur me kartë SIM. Vlerën më të madhe të këtij treguesi e ka Plus me 28%, ndërsa më të ultën Vodafone me 5%. Përdoruesit me kontratë përbejnë 16% të numrit të përdoruesve aktive, ku Eagle Mobile dhe Plus kanë vlerat më të larta me 46% dhe 42% respektivisht, ndërsa Vodafone ka vlerën më të ulët me 7%.

Trafiku telefonik dhe struktura e thirrjeve

Gjatë vitit 2012 thirrjet dalëse të përdoruesve celularë u rriten me 24% në krahasim me vitin 2011, një normë më madhe rritje vjetore se në 2011 (17%). Rritjen më të madhe e ka pasur Plus me 66% dhe rritjen më të vogël Eagle me 6%. Thirrjet brenda rrjetit përbëjnë 93% të totalit të thirrjeve dalëse duke vazhduar tendencën e viteve të fundit dhe përdorimin e madh të paketave tarifore me tarifa shumë të ulëta për thirrjet brenda grupeve të mbyllur. Përkundraiz, pesha e këtyre thirrjeve varion nga 80% në Plus në 95% në Vodafone. Viti 2012, shënoi një rritje të madhe me 94% të numrit të SMS-ve të dërguara nga përdoruesit celularë në krahasim me 2011.

Terminimi i thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera në vitin 2012 u rrit me 7% në krahasim me 2011. Plus ka rritjen më të madhe me 168% ndërsa AMC dhe Eagle Mobile kanë rënie me 14% dhe 13% respektivisht, ndërsa Vodafone ka një rritje me 6%. Struktura e thirrjeve hyrëse nga rrjetet e tjera ndryshon sipas operatorëve. Thirrjet hyrëse ndërkombëtare përbëjnë më së shumti 72% të thirrjeve hyrëse por që varion nga 34% në Plus në 79% në Vodafone. Thirrjet hyrëse nga rrjetet e tjera celularë përbëjnë më së shumti 26% të thirrjeve hyrëse por që varion nga 19% në Vodafone në 63% në Plus.


Te ardhurat e operatorëve celularë

Për vitin 2012, të ardhurat totale për të katër operatorët celularë ishin rreth 42.01 miliardë lekë, kundrejt 39.2 miliardë lekë që ishin në vitin 2011, pra siç vëhet re në sektorin celular ka një rritje të të ardhurave për vitin 2012 rreth 7.2 %, krahasuar me vitin 2011.

Në figurën e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave celularë në periudhën 2004-2012, ku mund të vëhet re se në vitin 2012 ka pasur një rritje të të ardhurave në krahasim me vitin e mëparshëm 2011, rritje e cila kryesisht është reflektuar nga rritja e të ardhurave të Vodafone dhe Plus, përkatësisht Vodafone ka një rritje me rreth 16 %, kurse Plus ka një rritje prej rreth 144%, krahasuar me të ardhurat e vitit 2011.

Ndërsa dy operatorët e tjerë, AMC dhe EM kanë një rënie në të ardhurat e tyre krahasuar me 2011, përkatësisht AMC me 7 %, kurse EM ka rënie me 11%.

Figura 9: Ecuria e te ardhurave te operatoreve celulare 2004-2012



Në tabelen e mëposhtme paraqitet ecuria e pjesëve të tregut për 2010-2012 për numër pajtimtarësh, thirrje dalëse dhe SMS dhe për të ardhurat (2009-2012). Nga të dhënat vihet re se pjesët e tregut të AMC janë reduktuar për katër tregues dhe rritje të vogël për SMS. Në 2012 pjesët e tregut të AMC për treguesit e dhënë në tabelë variojnë nga 31-36%. Në krahasim me 2011, Vodafone ka pjesë tregu më të stabilizuara për të gjithë treguesit përveç reduktimit në pjesën e tregut për përdorues me kontratë. Vodafone ka pjesë tregu shumë të madhe për SMS me 73% dhe në nivele 50-52% për thirrje dalëse dhe të ardhura, ndërsa ka pjesë të vogël tregu për përdorues me kontratë. Eagle Mobile ka pjesën më të madhe të tregut për përdorues me kontratë, ndërsa ka një diferencë të madhe në pjesët e tregut të përdoruesve të matur me kartë SIM dhe përdorues aktive (25% dhe 12% respektivisht). Plus në 2012 ka ndryshime të vogla ose të njëjten pjesë tregu si në 2011 për përdorues (kartë SIM dhe përdorues aktive), thirrje dalëse dhe SMS, ndërsa ka rritje në pjesën e tregut të përdoruesve me kontratë nga 7% në 15%.

Tabela 4: Pjesët e tregut celulare për disa tregues kryesore 2010-2012

		AMC	VODAFONE ALBANIA	EAGLE MOBILE	PLUS COMMUNICATION
Përdorues (Karta SIM)	2012	33%	36%	25%	6%
	2011	37%	35%	21%	8%
	2010	44%	37%	18%	1%
Përdorues	2012	40%	42%	12%	6%
	2011	37%	44%	13%	6%

Aktive	2010	44%	36%	19%	1%
Perdorues me Kontrate	2012	31%	18%	36%	15%
	2011	35%	24%	34%	7%
	2010	43%	30%	27%	-
Thirrje dalese	2012	39%	50%	8%	3%
	2011	37%	51%	10%	2%
	2010	46%	45%	9%	-
SMS	2012	20%	73%	6%	1%
	2011 ²	27%	64%	8%	1%
	2010	34%	57%	9%	-
Te ardhura	2012	29%	56%	10%	5%
	2011	34%	52%	12%	2%
	2010	40%	48%	12%	-

Perdorimi mesatar i shërbimeve celulare

Ne vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mujor për përdorues celularë në 2011 dhe 2012. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Vlerat janë raportuar duke përdorur vlerat e trafikut dalese dhe hyrese gjatë vitit 2012 dhe numrin mesatar të përdoruesve gjatë vitit 2012 (mesatarja e fundit të vitit 2011 dhe fundit të vitit 2012). Gjithashtu treguesit janë llogaritur për numrin e përdoruesve celularë sipas kartave SIM dhe përdorues aktive.

Tabela 5: Përdorimi mesatar i shërbimeve celulare 2011-2012

	2011	2012	Ndryshimi Vjetor
Perdorues Karta SIM			
Thirrje dalese në muaj	83	93	12%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	94	103	9%
MOU*	177	195	10%
SMS (dalëse) në muaj	12	21	75%
Perdorues Aktive			
Thirrje dalese në muaj	130	152	17%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	147	168	14%
MOU*	277	319	15%
SMS (dalëse) në muaj	19	35	83%

² Pjesët e tregut për SMS për vitin 2011 të publikuara më parë janë korrigjuar. Lexuesi lutet t'i referohet këtyre vlerave të rishikuara për SMS për vitin 2011.

Ne vitin 2012 ka vazhduar tendenca e rritjes së përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike që ka filluar në vitin 2009, dhe rritja vjetore ishte më e madhe se në 2011. Konsumi i thirrjeve është rritur mesatarisht me 9-12%, e matur me përdorues sipas kartave SIM, dhe 14-17% e matur sipas përdoruesve aktive. Përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 75-83%.

Në vitin 2012, një përdorues celular ka kryer mesatarisht 93 minuta thirrje dalese dhe ka marrë 103 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar në 195 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe ka dërguar 21 SMS në muaj. Nëse do të referoheshim konsumit mesatar për një përdorues aktive, këto vlera janë shumë më të mëdha: 319 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe 35 SMS në muaj.

AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më afër treguesve të matur me përdorues aktive, pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh të kartave SIM janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karta SIM të operatorëve celularë Shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohshëm apo vizitave në Shqipëri).

Sherbimi Roaming

Tabela 6: Sherbime roaming nderkombetar 2010 dhe 2012

	2010	2011	2012
Numri i pajtimtareve të rrjeteve Shqiptare që kanë përdorur Roaming Nderkombetar	549,703	954,586	961,188
Numri i pajtimtareve të rrjeteve të huaja që kanë përdorur Roaming Nderkombetar në Shqipëri	2,703,290	4,243,532	5,849,021

Vihet re që shërbimi roaming për vitin 2012, krahasuar me vitin 2011 ka një rritje në të dy treguesit e evidentuar në tabele, si për pajtimtarët e rrjeteve shqiptare që përdorin roamingun nderkombetar duke pësuar një rritje shumë të vogël, rreth 1%, gjithashtu edhe për pajtimtarët e rrjeteve të huaja që përdorin roamingun në Shqipëri me një rritje rreth 38%. Faktoret e rritjes mund të kenë lidhje si me efektin e levizjes së lire gjithashtu edhe me prezencën e turistëve në sezonin turistik.

Sherbimi mesazheve MMS

Përdorimi i shërbimeve MMS për vitin 2012, është rreth 409 mijë (të dërguara dhe të marra nga abonentët e rrjeteve gjatë 12 muajve), krahasuar me vitin 2011 ku i njëjti tregues është rreth 563 mijë MMS.

Sherbime te reja: 3G

Pervec dy ofruesve te sherbimit 3G, si Vodafone Albania dhe AMC, gjate vitit 2012 eshte dhene edhe autorizimi i trete per Eagle Mobile. Tabela e meposhteme paraqet te dhenat per numrin e perdoruesve te sherbimeve 3G per vitet 2011 dhe 2012. Perdoruesit jane ndare ne perdorues 3G nepermjet aparatit celular dhe perdorues 3G nepermjet kartave modem USB te cilat perdoren per akses ne PC, lap top.

Tabela 7: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2012)

	Viti	AMC	VODAFONE	TOTAL
Numri pajtimtareve te telefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS ne total:	2011	55,000	228,249	283,249
	2012	240,715	408,998	649,713
	Ndryshimi %	338%	79%	129%
- nepermjet aparatit te telefonit celular	2011	46,000	202,756	248,756
	2012	222,882	371,426	594,308
	Ndryshimi %	385%	83%	139%
- nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	2011	9,000	25,493	34,493
	2012	17,833	37,572	55,405
	Ndryshimi %	98%	47%	61%

Nga tabela vihet re se numri i perdoruesve 3G ka rritje te madhe ne 2012 ne rapor me 2011, ne total me 129%, dhe 139% dhe 61% per perdoruesit me aparate celulare dhe me karta USB/modem respektivisht. Rritjen me te madhe e ka patur AMC por Vodafone ka pjesen me te mdahe te perdoruesve (AMC filloi ofrimin e sherbimeve ne Nentor 2011).

Portabiliteti

Ne vitin 2012, portabiliteti i numrit tregoi se ishte nje mase rregullatore e suksesshme. Sasia e numrave tecelulare te bartur ne vitin 2012, ka qene rrethe 2.5 here me larte krahasuar me nje vit me pare dhe ka arritur ne nje shifer prej 136998 ne total. Rritja e konkureses efektive ka bere qe ne treg te vazhdojne te hidhen oferta dhe plane tarifore te reja me perfitim per konsumatorin. Perdoruesit vazhdojne te tregohen aktive duke zgjedhur rrjetin dhe planet tarifore nga te cilat perfitojne dhe qe u pershtaten me mire kerkesave personale. Numri i perdoruesve te cilat kane perfituar nga planet e reja tarifore eshte disa here me i madh se numri i bartjeve.

Koha mesatare qe i duhet nje pajtimtari per te bartur numrin, nga momenti i dergimit te kerkekes deri ne marrjen e sherbimit nga operatori i ri eshte 1.6 dite, ndersa koha mesatare qe abonentet ngelen pa sherbim eshte rreth 75 minuta.


IV. TELEFONIA FIKSE

IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2012 pati rënie me rreth 27000 apo 8% në krahasim me vitin 2011. Rënia ka ardhur për shkak të reduktimit të numrit të pajtimtareve të Albtelecom me rreth 29 mijë ndërsa numri i pajtimtareve të operatoreve alternative nuk ka pasur ndryshime të ndjeshme. Tendënca në ulje të numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse duket se po ndjek atë të vendeve të BE, megjithatë norma e penetrimit të telefonisë fikse (11%) në Shqipëri vazhdon të jetë e ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej rreth 35%) dhe vendet e rajonit.

Numri i pajtimtarëve të Albtelecom ka vazhduar të reduktohet si edhe në dy vitet e mëparshme 2010 dhe 2011, por me një reduktim edhe më të madh. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse dhe Albtelecom dhe operatoreve alternative.

Figura 10. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2012




Numri total i pajtimtareve te operatoreve alternative nuk ka pasur ndryshime te ndjeshme nga viti 2011. Nder operoretet alternative kryesore rritje kane pasur ABCom dhe Nisatel me 21% dhe 11% respektivisht. Ndersa operoretet tjere si AMC (AMC fiks), Primo dhe ASC kane pasur rnie me 19%-24% te numrit te pajtimtareve ne 2012 ne krahasim me 2011. Renia e numrit të pajtimtarëve të Albtelcom ka cuar në reduktimin e pjesës së tregut të Albtelcom nga 76% në 2011 (84% ne 2010) ne 74% ne 2012. Operoretet alternative nuk kane ndryshime ne pjeset e tregut, pervec ABCom qe ka rritur pjesen e tregut nga 8% ne 2011 ne 11% ne 2012.

Tabela 8: Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2011-2012)

	Albtelcom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	AMC Fiks	OA te tjere	Total
2012	230,397	33,000	7,649	5,500	2,584	6,119	26,412	311,661
2011	258,943	27,167	10,129	4,950	3,300	7,565	26,790	338,844
2010	277,763	19,975	7,408	5,900	3,678	-	16,778	331,502
Ndryshimi 2012/2011	-11%	21%	-24%	11%	-22%	-19%	-1%	-8%

Figura 11: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2012)



V. INTERNETI

V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre

Numri pajtimtareve me akses broadband fikse dhe celular (3G me karta USB/modem) ne fund te vitit 2012 arriti ne rreth 215 mije qe perben nje rritje me rreth 24% ne krahasim me vitin 2011. Numri i pajtimtareve me akses broadband me rrjete fikse pati nje rritje prej 15%, ku shumica e operatoreve kane pasur rritje te numrit te pajtimtareve, perfshire edhe Altelecom qe pati nje rritje ne 2011. Altelecom ne 2012, pati rritje me 11% te numrit te pajtimtarëve broadband. Nder operatorët alternativë fikse ABCOM vazhdon të jete operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 36 mije ne fund te vitit 2012, që përbën një rritje prej 22% nga viti 2011. Rritje të madhe kane pasur edhe Abisnet dhe ASC si dy operatorët e tjere alternative me te medhenj me 16% secili.

Numri i pajtimtareve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem per perdorim me kompjuter) ne fund te 2012, arriti ne 55 mije nga 34 mije ne fund te 2011, qe perben nje rritje me 61%. Te dy operatorët celulare Vodafone dhe AMC, kane pasur rritje te ndjeshme me 47% dhe 98% respektivisht. Rritje te madhe me 139% pati edhe numri i perdoruesve me akses broadband 3G nga aparatet celulare, duke arritur ne fund te 2012, ne 594 mije nga 248 mije ne fund te 2011.


Tabela 9: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2010-2012)

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Fiks	AMC	Vodafone	Total Fiks +3G
2010	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000			120000
2011	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697	9,000	25,493	174,190
2012	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088	17,833	37,572	215,493
Ndryshimi 2012/2011	11%	22%	16%	16%	12%	15%	98%	47%	24%


Pjeset e tregut ne vitin 2012, nuk kane ndryshime te ndjeshme me ato te vitit 2011. Albtelecom ka humbur pjese tregu ne aksesin broadband fiks nga 43% ne 2011 (58% në 2010) ne 42% ne 2012. Operatoret e tjere kane shtime te vogla ne pjeset e tregut ne krahasim me shtimin ne 2011.

Figura 12: Pjeset e tregut per akses broadband (2012)

Broadband fiks 2012



Broadband fiks dhe Celular 3G 2012



V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna në lidhje me infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët për rrjete me fibr optike dhe lidhjen me Internetin global (lidhje me botën). Nga të dhënat vëhet re se konektiviteti me Internetin Global nuk ka pasur ndryshime në raport me vitin 2011 dhe vazhdon të jetë në rreth 30 Gbps. Nderkohe gjatësia e fibres optike të instaluar nga operatorët është rritur me rreth 100 km në raport me vitin 2011.

Tabela 10. Të dhëna për infrastrukturën e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2011

	Alternative	Albtelecom	Total
Konektiviteti me Internetin Global –Lidhje nderkombetare (Gbps)	10	20	30
Fibër Optike të instaluar (gjatësia km)	1,914	2,837	4,751